

**AKTI I THEMELIMIT**  
**TË**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"CAR PLUS" SHPK**

Sipas Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar, themeluesi i vetëm i shoqërisë:

Z. Michael Walter Knecht, shtetas austriak, lindur më datë 09.03.1967 në Bludenz, me numër pasaporte U 0916692, banues në Rankweil;

sot në datë 09.09.2022

**VENDOSI**

të krijojë dhe themelojë një shoqëri tregtare dhe, lidhur me këtë qëllim, të miratojë këtë AKT THEMELIMI me përmbajtjen e mëposhtme:

**Neni 1**

**Emri i Shoqërisë**

- 1.1 Emri i shoqërisë është "CAR PLUS" SHPK (i ndjekur në mënyrë të pandashme nga prapashtesa 'SHPK'), që përfaqëson formën juridike të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2 "CAR PLUS" SHPK do të ketë logon dhe vulën e saj, e cila miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

**Neni 2**

**Forma juridike**

- 2.1 Shoqëria është person juridik shqiptar, e cila ka formën juridike të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil në fuqi, Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, dhe dispozita të tjera ligjore në fuqi të ligjit shqiptar.

**Neni 3**

**Objekti**

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:
  - zhvillimi i software-ve,



- shitblerja e makinave, dhe
  - shitblerja e pasurive të paluajtshme.
- 3.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me dispozitat ligjore.

#### **Neni 4**

##### **Kohëzgjatja**

- 4.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj për një kohë të pacaktuar.
- 4.2 Vendosja e mëpasshme e një afati është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 5**

##### **Selia**

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga "Abdyl Frashëri", Qendra Hekla, Pallati 31, Hyrja A, Kati 6, Apartamenti 18, Tiranë.
- 5.2 Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë këtij territori, duke hapur zyra ose degë ose nëpërmjet veprimtarive të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 6**

##### **Kapitali Fillestar**

- 6.1 Kapitali fillestar i shoqërisë është 13 000 (*trembëdhjetë mijë*) Euro, me vlerë ekuivalente<sup>1</sup> prej 1 529 060 (*një milion e pesëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëdhjetë*) Lekë i përbërë nga 1 (një) kuotë.
- 6.2 Pjesëmarrja në kapitalin e Shoqërisë është: Z. Michael Walter Knecht, mbajtës i pasaportës nr. U 0916692, zotëron 1 (një) kuotë me një vlerë totale prej 13 000 (*trembëdhjetë mijë*) Euro me vlerë ekuivalente prej 1 529 060 (*një milion e pesëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëdhjetë*) Lekë, e cila përbën 100% të kapitalit të Shoqërisë.
- 6.3 Të gjitha pjesët e kapitalit janë nënshkruar dhe paguar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.

#### **Neni 7**

##### **Organi Vendimmarrës**

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë përbëhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- 7.2 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim në Statutin e Shoqërisë në përputhje me modalitetet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- 7.3 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme:

---

<sup>1</sup> Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 09.09.2022 është 1 euro = 117.62 lekë.



- a. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - b. ndryshimet në statut;
  - c. emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ve;
  - d. emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ve dhe ekspertit/ëve kontabël;
  - e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të përmendura më sipër;
  - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratori/ët, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së aktivitetit;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të progresit të aktivitetit;
  - h. gj) rritja dhe pakësimi i kapitalit të regjistruar;
  - i. ndarjen e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j. përfaqësimi i Shoqërisë në gjykatë dhe në procese të tjera kundër Administratorit/ve;
  - k. riorganizimin, falimentimin, likuidimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë;
  - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
  - m. çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji ose Statuti dhe që nuk janë kompetencë e Administratorit/ve.
- 7.4 Çdo ndryshim në Statutin e Shoqërisë depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ('QKB') për të pasqyruar ndryshimet në dosjen e Shoqërisë.

#### Neni 8

##### Kourumi

- 8.1 Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

#### Neni 9

##### Administratori

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme emëron 1 (një) Administrator të Shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë rinovimi.
- 9.2 Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë: **Z. Michael Walter Knecht**, i biri i Walter, shtetas austriak, datë 09.03.1967, lindur në Bludenz dhe banues në Rr. Koehlerstrasse 11, 6830, Rankweil, e pajisur me pasaportë nr. U 0916692.
- 9.3 Administratori ka të gjitha kompetencat si organ ekzekutiv i Shoqërisë për të vepruar në lidhje me të tretët në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji i cakton shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.
- 9.4 Emërimi, zëvendësimi ose shkarkimi i Administratorit bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm / Asamblesë së Përgjithshme.

## Neni 10

### Përgjegjësitë e Administratorit

10.1 Përveç sa parashikohet në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Administratori është i detyruar:

- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në Statut në mirëbesim dhe në interesin më të lartë të Shoqërisë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë veprimtarisë së Shoqërisë në mjedisin tregtar;
- të ushtrojë kompetencat e njohura në ligj dhe në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- të parandalojë dhe shmangë rastet e konfliktit, të tanishëm ose të ardhshëm, dhe të konfliktit të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
- të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e duhur, siç kërkohet në dispozitat ligjore në fuqi.

10.2 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi kryhet me mirëbesim dhe kur veprimi autorizohet nga Asambleja e Përgjithshme.

## Neni 11

### Pajtueshmëria ligjore

11.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë në përputhje me ligjin shqiptar dhe çdo zhvillim korporativ i Shoqërisë, si bashkime, blerje, transferim kuotash etj., do të kryhet sipas ligjit shqiptar.

11.2 Në rast mosmarrëveshjeje në lidhje me rastet e mësipërme të parashikuara në pikën 11.1 më sipër, forumi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jenë gjykatat kompetente shqiptare.

## Neni 12

### Shpërbërja

12.1 Shoqëria mund të shpërbëhet në çdo kohë:

- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- me mbylljen e procedurave të falimentimit ose likuidimit vullnetar;
- nëse nuk kryen veprimtari tregtare prej 2 (dy) vitesh dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

- me vendim gjykate.
- 12.2 Në këtë rast, Ortaku i Vetëm / Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e shpërbërjes së Shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidues dhe duke shënuar në çdo dokument të lëshuar prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtimin shtesë "Shoqëri në likuidim".
- 12.3 Shpërndarja e Shoqërisë rezulton me hapjen e procedurave të likuidimit jashtë gjendjes së falimentimit, me përjashtim të rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit të emëruar nga Ortaku i Vetëm / Asambleja e Përgjithshme.
- 12.4 Nëse Ortaku i Vetëm / Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim për emërimin e likuidatorit(ve), brenda 30 ditëve pas shpërbërjes, çdo person i interesuar mund të aplikojë në gjykatë për të caktuar një likuidues.

\* \* \*

Ky AKT THEMELIMI është përgatitur në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM

Z. Michael Walter Knecht

